

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E HËNË 23 MAJ 2022

Të nderuar deputetë dhe qytetarë,

Qëllimi i përgatitjes së këtij projektligji është miratimi i marrëveshjes për administrimin e fondacionit të posaçëm ndërmjet ministrisë përgjegjëse të Kulturës dhe Fondacionit. Modeli i administrimit të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit, i parashikuar nga marrëveshja e administrimit, tërthorazi, përmes krijimit të një fondacioni të dedikuar, erdhi si nevojë për gjetjen e mënyrave të reja të administrimit, pasi sistemi aktual i menaxhimit, edhe pse ka siguruar i sforcuar mbrojtjen e vlerave kulturore, të gjithë e dimë se nuk ka arritur nivelet maksimale të ruajtjes dhe përmirësimit të vlerave kulturore të këtij objekti, që është i një rëndësie shumë të veçantë. Dëgjuam shumë diskutime.

Zonja Bushka tha se janë keqinformuar ose keqinformojnë opinionin, por unë do të thosha se flasin thjesht për politikë, sepse nuk gjej arsye apo motiv tjetër. Të kundërshtosh do të thotë të duam një Butrint të rrethuar me tela me gjemba, dyer të lidhura me zinxhirë ose drunj të mëdhenj, dhe jo një Butrint siç realisht i takon, edhe në bazë të historisë, kur flitet se është një nga zonat më të vjetra, që ka pasur qytetërim prej 500 brezash ose 12 mijë vjet. Mendoj se për këtë qëllim marrëveshja e administrimit është e drejtë dhe e bazuar jo vetëm në ligjin nr. 27/2018, por edhe në përvojat e vendeve të tjera. Këtu u tha se mjafton të na jepni një shembull, një rast, dhe unë do t'ju them se mjafton të futeni në një faqe, po marr Italinë si shembull, dhe të kërkonti OJF që menaxhojnë vepra të artit dhe të kulturës. Nuk do t'ju dalë një, por do t'ju dalin me qindra.

Meqenëse zonja Zhupa do një rast, është fondacioni dell'antico Indicie di Torino. Mund t'i numëroj disa raste. E përmenda jo më kot, sepse e dija që zonja Zhupa do të reagoje pas kësaj. Në komision është përmendur nga zonja Zhupa se: "është fitim ekonomik". Unë nuk e di nëse e keni përmendur me qëllim apo çfarë do të thotë realisht "fitim ekonomik". Fitim ekonomik nuk është fitimi kontabël. Pra, fondacioni nuk do të realizojë një rezultat kontabël, do të fitojë disa lekë, që do t'i përfitojë, por fitimi ekonomik është diferenca midis fitimit kontabël dhe kostove që ajo ka. Pra, pjesa që do t'i ngelet fondacionit do të menaxhohet për të përmirësuar vlerat e Butrintit. Mjafton të shikoni se të ardhurat në vitin 2018 nga Butrinti kanë qenë 900 mijë euro dhe në bazë të planbiznesit që ka paraqitur Fondacioni,

flitet se në vitin e 4-rt kjo vlerë të jetë 1,3 milionë euro, ndërsa në vitin e 7-të të arrijë deri në 3,7 milionë euro dhe të ketë këtë vijimësi.

Gjithashtu, flitet për hapjen e vendeve të reja të punës. Si rezultat jo vetëm i menaxhimit të brendshëm dhe vendeve që do të krijohen direkt aty, por edhe si rezultat i përfitimeve që do të ketë zona përreth, flitet për një shtim të numrit të fuqisë punëtore deri në 111 persona, që është në planin e biznesit që ata kanë parë dhe kanë paraqitur. Pra, nëse do ta shikoni me vëmendje marrëveshjen, nuk flitet vetëm për përmirësimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore të Butrintit, por edhe për përfitime ekonomike të asaj vepre, por edhe të zonës përreth.

Nëse e keni parë planin e biznesit, për të cilin jo pa të drejtë, ju, por edhe ne, kërkuam të ishte prezent, pamë që edhe zona do të ketë investime në infrastrukturë, që do t'i shërbejnë Parkut Kombëtar të Butrintit dhe zonës përreth. Për sa u diskutua këtu, mendoj se kjo është marrëveshja dhe mënyra më e mirë e menaxhimit të një pasurie kombëtare, ndaj ju ftoj ta votoni. Faleminderit!